# MONITORUESI I DREJTËSISË

## 1 janar deri më 30 qershor 2014

Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë (OSBE) mbështetë përpjekjet e sektorit të drejtësisë në Kosovë për ta rritur përputhshmërinë me të drejtën ndërkombëtare për gjykim të drejtë dhe standardet e sundimit të ligjit. Për të ndihmuar në këtë përpjekje, OSBE-ja monitoron procedurat gjyqësore dhe raporton rregullisht mbi to. Monitoruesi i Drejtësisë është publikim gjashtëmujor i gjetjeve të monitoruesve të OSBE-së në gjykatat e shkallës së parë në Kosovë (Gjykatat themelore), të shpërndarë në shtatë rajonet vijuese: Ferizaj/Uroševac (FZ/UR); Gjakovë/Đakovica (GJ/DA); Gjilan/Gnjilane (GN); Mitrovicë/Mitrovica (MI); Pejë/Peć (PE); Prishtinë/Priština (PRN); Prizren (PZ). Monitoruesi i Drejtësisë synon që politikbërësve dhe akterëve të sektorit të drejtësisë t'u sigurojë treguesit e duhur, të cilët ndryshe nuk do të ishin në dispozicion, për t'i ndihmuar në identifikimin e mangësive të përputhshmërisë në ndarjen e drejtësisë, si dhe për ta përcjellë progresin e arritur në përmirësimin e mangësive në fjalë.

## Monitorimi nga OSBE

| Departamenti i drejtësisë | Dëgjime | Lëndë |
|---|---|---|
| Departamenti i përgjithshëm (raste penale) | 376 | 257 |
| Departamenti i përgjithshëm (raste civile) | 343 | 264 |
| Departamenti për krime të rënda | 318 | 187 |
| Departamenti për çështje administrative | 49 | 42 |
| Departamenti për të mitur | 21 | 13 |
| Gjithsej | 1107 | 763 |

Gjyqtarët e monitoruar në përqindje*




## Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm

### *Efikasiteti i gjykatave*

Në raportin e tij vjetor[+], Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka raportuar për 446,254 lëndë të grumbulluara deri më 1 janar 2014. Efikasiteti i gjykatave (që përkufizohet si lëndët e përfunduara / lëndët e pranuara) ishte në shkallë prej 79.64%. Pra, për 80 lëndë të zgjidhura, janë pranuar parashtruar 100 lëndë të reja.

Respektimi i afateve procedurale në rastet e monitoruara







Arsyet për shtyrje në seancat joproduktive




* Bazuar në listën e gjyqtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (pranuar më 3 korrik 2014), me përjashtim të gjyqtarëve të kundërvajtjes dhe departamenteve për çështje ekonomike të cilët nuk janë monitoruar.

[+] Këshilli Gjyqësor i Kosovës, "Raport Vjetor 2013: Statistikat e gjykatave", në dispozicion në http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/RAPORTI-VJETOR-2013_Final_620127.pdf

‡ Në një "seancë gjyqësore joproduktive" nuk ndodh asgjë që ka vlerë ose substancë (nuk janë marrë prova, nuk janë dëgjuar apo nuk është vendosur në propozime, nuk janë shqyrtuar çështje të menaxhimit të lëndëve, etj.)

# QASJA NË DREJTËSI




### *Numri i avokatëve*

Në Odën e Avokatëve të Kosovës janë 568 avokatë të regjistruar, ose 32 avokatë për 100,000 banorë. Në vitin 2012, Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë ka vlerësuar numrin e avokatëve në 48 juridiksione. Vetëm një juridiksion kishte më pak se 32 avokatë për 100,000 banorë.*







# MBROJTJA E PROVAVE

### *Regjistrimi i gjykimeve penale*

Neni 315(2) i Kodit të Procedurës Penale përcakton që "shqyrtimi gjyqësor regjistrohet në mënyrë audio ose video ose në mënyrë stenografike." OSBE ka monitoruar 407 seanca gjyqësore në raste penale. 19 prej këtyre seancave (5%) janë regjistruar në mënyrë audio dhe video. Transkripte stenografike ose fjalë për fjalë janë mbajtur në 79 (19%) seanca gjyqësore.




# VENDIMET E ARSYETUARA+







### *Seancat gjyqësore publike*

Publiku është përjashtuar në 95 (9%) nga 1107 seanca të monitoruara. Në 17 prej këtyre 95 seancave (18%) nuk është dhënë vendim i arsyetuar për përjashtimin, madje edhe përjashtimi nuk ka qenë qartësisht i bazuar në ligj.

*Komisioni Evropian për Efikasitetin e Sistemeve Gjyqësore, Raport vlerësues për Sistemet Evropiane të Drejtësisë (2012), f.309, në dispozicion në: http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/evaluation/2012/Rapport_en.pdf

+ Gjatë periudhës raportuese janë vërejtur dhe analizuar 195 aktgjykime dhe 495 vendime që nuk janë aktgjykime (më saktë, vendime që nuk i referohen zgjidhjes së lëndës në fjalë)